VENDIM
Nr. 203, datë 13.9.2018

MBI RINOVIMIN E LICENCËS NR. 73, SERIA FK08, TË SHOQËRISË "GEN–I TIRANA" SHPK, NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa "ç", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", si dhe në zbatim të nenit 4, pika 1, germa "d", nenit 5, pika 1, germa "d", neneve 13 dhe 16, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.9.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut për rinovimin e licencës nr. 73, seria FK08, të shoqërisë "Gen–I Tirana" sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria "Gen–I Tirana" sh.p.k., është mbajtëse e licencës nr. 73, seria FK08, për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 129, datë 2.12.2008, për një afat 5-vjeçar.
- Kjo licencë është rinovuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, me nr. 104, datë 1.10.2013, për një afat 5-vjeçar.
- Në prag të përfundimit të afatit kohor të licencës, shoqëria "Gen–I Tirana" sh.p.k., kërkon rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike në bazë të nenit 16, pika 1 (jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë, personi mund/duhet të kërkojë në ERE rinovimin e licencës duke paraqitur dokumentet përkatëse) të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike".
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 185, datë 20.8.2018, filloi procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë "Gen–I Tirana" sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Në vijim të sa më sipër, ERE me shkresën nr. 55/55 prot., datë 23.8.2018, publikoi në median e shkruar njoftimin për fillimin e kësaj procedure dhe me shkresën nr. 523/1 prot., datë 23.8.2018, i ka kërkuar subjektit "Gen–I Tirana" sh.p.k., të paraqesë në ERE dokumentacionin e munguar që ka të bëjë me bilancin financiar të vitit 2017, duke qenë se nga analiza e dokumentacionit të aplikimit, rezultoi se nuk ishte paraqitur.
- Subjektit "Gen–I Tirana" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 523/2 prot., datë 29.8.2018, ka paraqitur në ERE dokumentacionin e munguar, sipërcituar.
- Nga analiza që iu bë dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria "Gen–I Tirana" sh.p.k., gjatë fazës finale të shqyrtimit në bazë të "Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", rezulton si më poshtë:
- formati dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1. Plotësuar;
- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2. Plotësuar;
- dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3. Plotësuar;
- dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike, neni 9, pikat 4.7 dhe 4.7.1. Plotësuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të rinovojë licencën nr. 73, seria FK08, të shoqërisë "Gen–I Tirana" sh.p.k., në veprimtarinë e

furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti